

VENDIM
Nr. 903, datë 21.12.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIUMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË

(Ndryshuar me VKM nr. 450, datë 22.5.2017; nr. 697, datë 21.11.2018; nr. 39, datë 23.1.2019; nr. 755, datë 30.11.2019)

(përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në masën e përcaktuar në këtë vendim, studentët e pranuar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret, si më poshtë:

a) studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përlllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë:

i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës akademik të përlllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

2. Shfuqizuar.

3. Bursat e studimit për studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallura të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, u shpërndahen studentëve që studiojnë në këto programe dhe institucione. Studentët që

frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

3.1. Përjashtimisht, për vitin akademik 2018-2019, të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve, që plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe nuk kanë përfitur bursë të plotë sipas këtij vendimi, me vendim të njërive të vetëqeverisjes vendore apo me vendim të bordit të administrimit të LAL-ve publike, plotësojnë formularin e kërkesës dhe dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve përkatës për të përfitur nga e drejta për bursë financiare sipas këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës, LAL-të publike kryejnë verifikimet e nevojshme dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në bordin e administrimit. Bordi i administrimit miraton bursat për studentët që përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve. Këto bursa miratohen dhe jepen nga muaji janar 2019 dhe në vijim.

4. Studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë publik dhe që u përkasin shtresave sociale në nevojë, u akordohen bursa kur ata plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë.

5. Studentë në nevojë konsiderohen:

- a) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;
- b) bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;
- c) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- ç) studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- d) studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;
- dh) studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;
- e) studentët që kanë përfitur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- ë) studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;
- f) studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;
- g) studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

8. Studentët aplikojnë për bursë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve, në momentin e regjistrimit, pranë institucioneve publike të arsimit të lartë ose në momentin që plotësojnë kriteret sipas këtij vendimi.

9. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit, kryejnë verifikimet e nevojshme për plotësimin e tij në bashkëpunim me institucionet të cilat kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në bordin e administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

Bordi i administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë shqyrton dhe merr vendim për bursat financiare për studentët që përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studentët. Bursa financiare paguhet nga data e regjistrimit në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik ose nga muaji pasardhës kur studentët ka paraqitur kërkesën në rast plotësimi të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim gjatë vitit akademik. Vendimet e Bordit të administrimit për miratimin e bursave financiare bëhen publike dhe ankimohen, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

10. *Shfuqizohet.*

11. *Bursa financiare u jepet studentëve përfutës çdo muaj, në llogarinë bankare të deklaruar nga studentët, në bankat e nivelit të dytë, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga përgjegjësi i njësisë bazë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me IAL-të publike, sipas kriterëve të parashikuara në këtë vendim, parashikon numrin e pritsbëm të studentëve që përfitojnë bursë në periudhën afatmesme dhe efektet financiare, si pjesë e programit buxhetor afatmesëm.*

12. *Studentët që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi nuk trajtohen me bursë financiare.*

13. *Bursa financiare është në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.*

14. *Shfuqizuar.*

14.1 *Vetëm për vitin akademik 2019–2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, studentët të cilët ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe janë anëtarë të familjeve që kanë humbur persona ose që janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet publike të arsimit të lartë identifikojnë studentët dhe dërgojnë listat e studentëve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin.*

15. *Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për bursa për një vit të caktuar akademik përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhat përkatëse buxhetore.*

16. *Ngarkoben Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

ANEKSI 1
MASA E BURSËS PËR STUDENTËT NË IAL PUBLIKE

Nr.	Kategoritë e bursave	Totali mujor i bursës në lekë
1	Universitetet dhe shkollat e tjera të larta	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë	8 900
	b) Gjysmë bursa , akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik.	4 450
2	Universiteti i Sporteve	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin programe studimi në fushën e edukimit fizik në të cilat parashikohet të kryhen orë praktikash sportive	9 410
	b) Gjysmë bursa , akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik.	4 705